

NR. PROTOKOL 467

DATË 21.09.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR  
ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË

Nr. 5005/1 Prot.

Tiranë, më 17.09.2021

Lënda: Dërgohet urdhri për njohje dhe zbatim

**AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË**

*Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë*

**QENDRËS SË SHËRBIMEVE ARSIMORE**

*Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë*

**QENDRËS NDËRINSTITUCIONALE TË RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR**

*Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë*

**KOLEGJIT UNIVERSITAR "INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË"**

*Adresa: Rr. "Xhanfize Keko", Kompleksi Xhura, Tiranë*

Bashkëlidhur gjeni për njohje dhe zbatim urdhrin e Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si më poshtë:

- Urdhër nr. 345 datë 17.09.2021 "Për hapjen e programit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Marketing Digjital" në Fakultetin e Ekonomisë, në Kolegjin Universitar "Instituti Kanadez i Teknologjisë".

Duke ju falënderuar,

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Alqi KUSHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 5005 Prot.

Tiranë, më 17.9. 2021

**URDHËR**

Nr. 345, Datë 17.9.2021

**PËR**

**HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË “MASTER I SHKENCAVE” NË “MARKETING DIGJITAL”, NË KOLEGJIN UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të neneve 35 dhe 75 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

**URDHËROJ:**

1. Hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Marketing Digjital” me 120 kredite dhe kohëzgjatje 2 vite akademike (4 semestra), në gjuhën angleze, me formë studimi me kohë të plotë.  
Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diplomë e ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Marketing Digjital”, në Fakultetin e Ekonomisë, në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
2. Veprimtaria akademike në programin e studimit të ciklit të dytë “Master i shkencave” në “Marketing Digjital”, në Fakultetin e Ekonomisë, në Kolegjin Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”, fillon në vitin akademik 2021-2022.
3. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” të marrë masa që programi i studimit t’i nënshtrohet procesit të akreditimit, sipas afateve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
4. Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë” të zbatojë procedurat e aplikimit për regjistrimin e formës së diplomës së këtij programi studimi, pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe të përshtasë aktet e brendshme rregullatore, në zbatim të këtij urdhri.

5. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ushtron kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucionin e arsimit të lartë, në zbatim të këtij urdhri.
6. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përputhshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Kolegji Universitar “Instituti Kanadez i Teknologjisë”.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Evis KUSHI**

